

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 14 TETOR 2021

Të nderuar qytetarë,

Kriza që ka kapluar sot Shqipërinë është, mbi të gjitha, krizë e qeverisë me kryeshkaktar Ramën, i cili ka mbërthyer prej tetë vjetësh edhe qarkun e Dibrës. Qarku i Dibrës është më i varfëri në Republikë, pavarësisht resurseve të mëdha natyrore, minerare, bujqësore dhe agroturistike. Në këta 31 vjetë demokraci kemi dy kryeministra që kanë ndjellë krizë, ish- kryeministrin Bufi, i fundit i Partisë së Punës, që futi në krizë vendin me 7 ditë bukë dhe Ramën e “Rilindjes”, i cili mbjell frikë pa arsye dhe është i vetmi kryeministër që lumturohet kur ka fatkeqësi natyrore dhe kriza për t’i shfrytëzuar për propagandë. Por është edhe i vetmi kryeministër që krijon kriza nëpërmjet rritjes së taksave, emigracionit, oligarkëve, drogës, krimit dhe korrupsionit, i bindur që shumë shpejt do të ndodhë rotacioni i tij. Miniera e Bulqizës është kthyer në makth për minatorët dhe në ar për qeverinë e oligarkët, por ende nuk ka asnjë hap për miratimin e statusit të minatorit. Në minierën e Bulqizës vetëm pak ditë më parë humbi jetën një minator për shkak të neglizhencës së qeverisë apo edhe të pushtetit vendor, për të mos folur më pas për fëmijët që punojnë duke mbledhur gurë kromi për të siguruar bukën e gojës. Po çfarë bën Kryeministri ynë?! Rrit çmimin e bukës. Por ky shtet nuk ka as informacionin më të vogël për galeritë informale apo për mafien e krimit ose të kromit. Atje ka me qindra minatorë të pasiguruar, me paga minimale, të cilat nuk sigurojnë as mbijetesën e tyre. Të nderuar qytetarë, kriza e kësaj qeverie, për fat të keq, tashmë po u faturohet qytetarëve të varfër me rritjen e çmimeve, për shkak të një pakete fiskale progresive, informalitetit të lartë nga oligarkët dhe mungesës së një platforme të qartë të zhvillimit të ekonomisë prodhuese për të rritur punësimin dhe eksportin, ndërkohë sektori i ndërtimit po lulëzon për shkak të parave të krimit, të drogës, korrupsionit dhe të remitancave.

Të nderuar kolegë, a është normale që në një vend janë larguar mbi 70% e të rinjve, ku mbi 97% e familjeve nuk sigurojnë të drejtat më elementare për ushqim dhe për veshje për fëmijët e tyre, ku paga mesatare është 69% më e ulët sesa paga e vendeve të Bashkimit Europian, ku të ardhurat për frymë janë më të ulëtat në rajon? Pjesa dërrmuese e qytetarëve jetojnë me ndihmën ekonomike vetëm 4 mijë lekë në muaj ose pa asnjë të ardhur. Si mund ta përballojnë rritjen e çmimit të bukës, të produkteve të shportës, të energjisë elektrike apo edhe rritjes së naftës?! Mbi 170 mijë banorë në Dibër vuajnë furnizimin me dru zjarri, ku një metër kub dru zjarri kushton 80 mijë lekë, është bërë monopol nga qeveria, është e papranueshme në një zonë që ka dru pa fund dhe çmimi i tyre thyen çdo rekord. Edhe pse ky qark ka resurse në bujqësi, asnjë investim nuk është bërë. Bujqësia në rrethin a në qarkun e Dibrës është rrënuar si asnjëherë tjetër, ka me mijëra hektarë tokë për shkak të falimentimit të tregut; ka me mijëra hektarë tokë pa ujë që nuk mbillen; kemi me tonelata produkte bujqësore dhe blegtorale, të cilat hidhen apo groposen për shkak të mosshitjes së tyre, sepse nuk ka kapacitete për blerjen e tyre. Energjia elektrike është pothuajse dyfishuar në këta 8 vjet, pa asnjë investim të kryer dhe pa asnjë argument. Madje Shqipëria sot siguron rreth 100% të energjisë elektrike, ndërkohë që çmimi i saj nuk vendoset mbi bazën e kostos, por mbi bazën e shefave të Kryeministrit. Ne prodhojmë mbi 70% të nevojave për naftë, por, në fakt, kemi naftën më të shtrenjtë në rajon.

A keni informacion ju se çdo ditë në doganën e Bllatës shkojnë qytetarët e qarkut të Dibrës për të blerë produkte bujqësore, për të blerë naftë, për të blerë produktet e shportës, që kanë një xhiro ditore prej më shumë sesa 100 mijë euro ose 36 milionë euro në vit?